


Arrestohen dy persona, kanosen një tjetër për shkak të pronës

FaktePlus 13/04/2019, 10:36



Janë arrestuar dy persona pasi të njëjtit kanë kërcënuar një person tjetër për shkak të një prone të paluajtshme.



Policia e Kosovës njofton se personat e arrestuar i kanë dëmtuar disa shtylla betoni viktimës, derisa i kishin kërkuar edhe para për atë pronë.

“Janë arrestuar dy të dyshuar meshkuj K/Shqiptarë, të cilët për shkak të një prone të paluajtshme, e kanë kanosur viktimën mashkull K/Shqiptar me c’rast i kishin dëmtuar disa shtylla betoni. Të dyshuarit për atë pronë, i kishin kërkuar viktimës para”, thuhet në njoftimin e Policisë, raporton FaktePlus.

Gjatë bastisjes së të dyshuarve, Policia ka gjetur dhe konfiskuar një pushkë automatike AK47 dhe fishekë.